



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

**Informatë për media
10 dhjetor 2020**

**Presidentja dr. Vjosa Osmani dorëzoi dekoratën Urdhri Dr. Ibrahim Rugova,
për aktivisten dhe humanisten Sevdije Ahmeti**

Sot, 10 dhjetor, në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, u.d. Presidentja e Kosovës, dr. Vjosa Osmani dorëzoi dekoratën Urdhri Dr. Ibrahim Rugova, për aktivisten dhe humanisten Sevdije Ahmeti.

Në emër të Presidences, dekorata iu dorëzua familjes së Sevdije Ahmeti. Sevdije Ahmeti (1944-2016) ishte ideatorja dhe shtylla e lëvizjes së grave në Kosovë. Në mesin e mbrojtësve më të hershëm të të drejtave të grave si të drejta të njeriut në Kosovë, ajo ishte udhëheqëse, aktiviste, feministe.

Me 12 shkurt 2019, RrGK dergoi propozimin zyrës së Presidences e cila u aprovua nga Presidenti në kuadër të shënimit të 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, si nderim për kontribuesen e madhe të të drejtave të njeriut, veçmas të të drejtave të gruas.